



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Korrik 2021

Nr: 432

VENDIM

**PËR RIHAPJEN E SHORTIT PËR CAKTIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENSUAR
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA 2 SUBJEKTE
ZGJEDHORE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “ë”, dhe pika 2, 21, pika 1, shkronja “b”, 92/6, 92/7, si dhe 124/1, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 14 datë 9.6.2021, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore” dhe pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit dhe në zbatim të udhëzimit nr. 14 datë 9.6.2021, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, pas miratimit të listës paraprake të aplikantëve, organizoi më datë 12.7.2021 shortin online ku u përzgjodhën ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, të datës 25 prill 2021.

Më datë 23.7.2021 u rihodh shorti për të caktuar ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të auditojnë subjektet zgjedhore, të caktuara në shortin e datës 12.07.2021, me vendimin nr. 426, ekspertës kontabël të licensuar zj. Fatime Alliu, e cila u tërhoq nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, të datës 25 prill 2021

Ekspertja kontabël e licensuar (audituese ligjore), e cila u tërhoq nga ky proces kishte për të audituar fondet e përfituara dhe shpenzuara nga 2 subjekte zgjedhore, si më poshtë:



Data: 23 Korrik 2021
Nr. 432

Për rihapjen e shortit për caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 2 subjekte zgjedhore për fushatën zgjedhore, të datës 25 prill 2021

- 1) Partia Bashkimi Liberal Shqiptar;
- 2) Boiken Abazi.

Në 1 (një) enë transparente u vendosën 6 (gjashtë) shirita me emrat e ekspertëve kontabël të licensuar, të cilëve në shortin e datës 12.7.2021, me numër vendimi 426, u ka rënë për të audituar nga 1 (një) subjekt zgjedhor, që pasi u lexuan u futën në gogla me formë, ngjyrë dhe masë të njëjtë, ndërsa në enën tjetër transparente u vendosën 2 (dy) shirita me emrat e subjekteve zgjedhore, të cilët pasi u lexuan u futën në gogla me formë, ngjyrë dhe masë të njëjtë.

Përzgjedhja u bë duke tërhequr nga njëra enë transparente emrin e ekspertit kontabël të licensuar dhe duke tërhequr nga ena tjetër transparente emrin e subjektit zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Referuar neneve 19, pika 1, shkronja “ë”, dhe pika 2, 21, pika 1, shkronja “b”, 92/6, 92/7, si dhe 124/1, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 14 datë 9.6.2021, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Të miratojë rezultatin e rihedhjes së shortit për caktimin e 2 (dy) subjekteve zgjedhore ekspertëve kontabël të licensuar, si më poshtë:
 - 1) **Margarita Kalemasi (i shtohet)**
 - a. Partia Bashkimi Liberal Shqiptar.
 - 2) **Hidajete Kraja (i shtohet)**
 - a. Boiken Abazi.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

